

20231011916

Në bazë të nenit 63, paragrafi (4) dhe nenit 68, paragrafi (5), pika a) dhe d) të Ligjit të Sigurimit Pensional me Financim Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018, 245/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 180/2019 dhe 103/2021) Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional, në mbledhjen e mbajtur më 27.4.2023, miratoi:

RREGULLORE PËR TRANSFERIMIN E MJETEVE NDËRMJET FONDEVE TË DETYRUESHME PENSIONALE

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen më afërsisht:

a) transferimi i mjeteve (transferimi nga njëra llogari në tjetrën llogari individuale) ndërmjet fondeve të detyrueshme pensionale me të cilat menaxhojnë shoqëri të ndryshme për menaxhimin e fondeve të detyrueshme pensionale dhe/ose shoqëritë për menaxhim të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale (në tekstin e mëtutjeshëm: shoqëri) dhe llojin e të dhënave që dorëzohen ndërmjet shoqërive të ndryshme në procedurën e transferim dhe

b) procedura e tërheqjes së mjeteve nga llogaria e veçantë (transferimi nga nënlllogaria individuale në llogarinë individuale) dhe njoftimet dhe të dhënat që duhet të dorëzohen në procedurën e tërheqjes së mjeteve.

Procedura e transferimit dhe tërheqjes së mjeteve

Neni 2

(1) Mjetet nga llogaria individuale në një fond të detyrueshëm pensional transferohen në llogari individuale në fond tjetër të detyrueshëm pensional, pasi anëtari i fondit të detyrueshëm pensional është bërë anëtar në fond tjetër të detyrueshëm pensional.

(2) Mjetet nga nënlllogaria individuale e llogarisë së veçantë (në tekstin e mëtutjeshëm: nënlllogaria) transferohen në llogarinë individuale në fondin e detyrueshëm pensional, pasi i siguruari i shpërndarë përkohësisht është bërë anëtar i fondit të detyrueshëm pensional.

Neni 3

(1) Nëse i siguruari e zgjedh fondin e detyrueshëm pensional në cilëndo nënlllogari të hapur, shoqëria hap llogari individuale në emër të anëtarit dhe menjëherë i transferon mjetet nga nënlllogaria e llogarisë individuale në fondin e detyrueshëm pensional së bashku me të gjitha të dhënat e lidhura, në pajtim me dispozitat për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për llogaritë individuale të çdo anëtari të fondit të detyrueshëm pensional nga Rregullorja për llogaritë individuale.

(2) Nëse i siguruari nuk e zgjedh fondin e detyrueshëm pensional në të cilin është hapur nënlllogaria, shoqëria e cila menaxhon fondin e detyrueshëm pensional në të cilin është hapur nënlllogaria i transferon në fondin e detyrueshëm pensional të cilin e ka zgjedhur i siguruari, mjetet nga nënlllogaria së bashku me të gjitha të dhënat e lidhura, në pajtim me dispozitat për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për llogaritë individuale të çdo anëtari të fondit të detyrueshëm pensional nga Rregullorja për llogaritë individuale.

Neni 4

Pasi anëtari i fondit të detyrueshëm pensional është bërë anëtar i fondit tjetër të detyrueshëm pensional shoqëria e cila menaxhon fondin e detyrueshëm pensional i transferon në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional mjetet nga llogaria individuale së bashku me të gjitha të dhënat e lidhura, në pajtim me dispozitat për përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës për llogaritë individuale të çdo anëtari të fondit të detyrueshëm pensional nga Rregullorja për llogaritë individuale.

Neni 5

Gjatë transferimit të mjeteve nga njëri në tjetrin fond të detyrueshëm pensional zbatohen dispozitat nga neni 8 dhe 9 i kësaj rregulloreje.

Neni 6

(1) Agjencia e Mbikëqyrjes së Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (në tekstin e më tutjeshëm: Agjencia) në shoqërinë dorëzon të dhëna për të gjithë të siguarit e shpërndarë përkohësisht në fondin e detyrueshëm pensional me të cilin shoqëria menaxhon, e që janë bërë anëtarë të fondit tjetër të detyrueshëm pensional dhe për të gjithë anëtarët e fondit të detyrueshëm pensional ekzistues që kanë kaluar në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional.

(2) Në bazë të të dhënave të paragrafit (1) të këtij neni shoqëria përgatit listë të të gjitha nënllogarive dhe llogarive individuale që duhet të transferohen me të dhënat lidhur me to, numri i njësisë kontabël të çdo nënllogarive dhe llogarive individuale, të dhënat për vlerën e mjeteve të çdo nënllogarive dhe llogarive individuale dhe të dhënat për vlerën e përgjithshme të të gjitha nënllogarive dhe llogarive individuale në denarë.

(3) Vlera e mjeteve të çdo nënllogarive dhe llogarive individuale përlllogaritet dhe shndërrohet në denarë në bazë të vlerës së njësisë së kontabilitetit në datën e vlerësimit që i paraprin datës së dorëzimit të listës nga paragrafi (2) i këtij neni shoqërisë tjetër.

(4) Shoqëria e dorëzon listën e paragrafit (2) të këtij neni deri në orën 16:00 në datën që i paraprin datës së transferimit në shoqërinë e ardhshme përmes sistemit informativ të Agjencisë në formatet e skedave dhe tipin e të dhënave të caktuara në udhëzimin teknik që e përpunon Agjencia.

(5) Shoqëria ruajtësit të pronës ia dorëzon të gjitha të dhënat e nevojshme për evidentimin dhe realizimin e transferimit të mjeteve ndërmjet fondeve të detyrueshme pensionale në formatin e dakorduar paraprakisht në mënyrë të ndërsjellë.

(6) Nëse një ose më shumë shoqëri nuk i dorëzojnë listat nga paragrafi (2) i këtij neni në afatin e paraparë në paragrafin (4) të këtij neni, procedura e transferimit ndërpritet dhe shtyhet për datën e cila i paraprin datës së transferimit të ardhshëm.

Neni 7

Në bazë të listës së nenit 6, paragrafi (2) të kësaj rregulloreje, shoqëria e ardhshme i shndërron mjetet në darë në njësi kontabël në bazë të vlerës së njësisë kontabël të fondit të detyrueshëm pensional me të cilin menaxhon, në datën që i paraprin datës së transferimit.

Procedura e përcaktimit dhe e barazimit të mjeteve

Neni 8

(1) Shoqëritë dekodohen ndërmjet tyre për mënyrën e barazimit të mjeteve dhe transferimin e të dhënave në datën e transferimit të nenit 9 të kësaj rregulloreje.

(2) Barazimi bëhet pas përlllogaritjeve të bëra në bazë të të dhënave për nënllogaritë dhe llogaritë individuale nga lista e nenit 6, paragrafi (2) të kësaj rregulloreje.

(3) Në datën e transferimit shoqëria e njofton ruajtësin e pronës dhe jep urdhër për transferimin e shumës neto të cilën njëra shoqëri duhet ta transferojë në fondin tjetër të detyrueshëm pensional, në bazë të përlllogaritjes së bërë.

(4) Në bazë të urdhëresës, ruajtësi i pronës menjëherë e transferon shumën e nevojshme neto në llogarinë e fondit të ardhshëm të detyrueshëm pensional.

(5) Transferimi duhet të bëhet në kushte të cilat ofrojnë siguri dhe mbrojtje të të dhënave nga llogaritë individuale.

(6) Së bashku me mjetet të cilat transferohen, shoqëria e cila menaxhon fondin e detyrueshëm ekzistues pensional i transferon në fondin e ardhshëm të detyrueshëm pensional dhe të gjitha të dhënat e lidhura nga llogaria individuale.

(7) Shoqëritë dorëzojnë njoftim në Agjencinë në lidhje me transferimin e kryer të të dhënave dhe mënyrën e barazimit të mjeteve ditën e ardhshme të punës që vijon pas datës së transferimit. Njoftimi në Agjencinë i përmban të dhënat e cekura në Raportin për transferim të mjeteve në pajtim me Udhëzimin teknik për dorëzim të arkivit vjetor dhe raporteve nga bazat e të dhënave që i mbajnë shoqëritë pensionale.

Neni 9

Transferimi i mjeteve nga njëri fond në tjetrin fond të detyrueshëm pensional bëhet çdo të 15-tën ditë në muajin ose ditën e ardhshme të punës nëse dita e 15-të në muajin është ditë jopune.

Neni 10

Në rast të vonimit ose parregullsive tjera gjatë transferimit të shumës së barazuar shoqëria e cila e kryen transferimin i kompenson dallimet e ndodhura në shumën e mjeteve të transferuara.

Procedura e korrigjimit

Neni 11

(1) Nëse të dhënat për nënllogaritë ose llogaritë individuale nga neni 6 paragrafi (2) i kësaj rregulloreje nuk janë të saktë ose shoqëria nuk i dorëzon të dhënat në afatin e cekur në nenin 6, paragrafi (4) të kësaj rregulloreje, shoqëria e cila i ka përgatitur kryen korrigjim të të dhënave gjatë dorëzimit të ardhshëm të të dhënave për nënllogaritë dhe llogaritë individuale.

(2) Nëse ndërmjet datës së dorëzimit të të dhënave për nënllogaritë dhe llogaritë e nenit 6, paragrafi (4) të kësaj rregulloreje dhe dorëzimit të ardhshëm të të dhënave në rast të transferimit të shumës më të vogël se e sakta për shkak të gabimit ose dorëzimit jo në kohë, vlera e njësisë kontabël të fondit të detyrueshëm pensional nga i cili transferohen mjetet është zvogëluar, shoqëria e cila menaxhon me atë fond të detyrueshëm pensional e kompenson nga mjetet personale humbjen e dallimet ndërmjet shumës së saktë e cila është dashur të transferohet dhe shumës së transferuar, të shkaktuar nga zvogëlimi i vlerës së njësisë kontabël.

(3) Nëse ndërmjet datës së dorëzimit të të dhënave për nënllogaritë dhe llogaritë e nenit 6, paragrafi (4) të kësaj rregulloreje dhe dorëzimit të ardhshëm të të dhënave në rast të transferimit të shumës më të madhe se e sakta për shkak të gabimit, vlera e njësisë kontabël e fondit të detyrueshëm pensional në të cilën transferohen mjetet është zvogëluar, shoqëria e cila menaxhon fondin e detyrueshëm pensional nga e cila transferohen mjetet e kompenson nga mjetet personale humbjen e dallimet ndërmjet shumës së transferuar dhe shumës së saktë e cila është dashur të transferohet, të shkaktuar nga zvogëlimi i vlerës së njësisë kontabël.

Dispozitat përfundimtare

Neni 12

(1) Kjo rregullore hyn në fuqi një dit pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

(2) Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për transferim të mjeteve ndërmjet фондеве të detyrueshme pensionale (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 100/2013).

Nr. 01-677/5
28.4.2023
Shkup

Kryetar
i Këshillit të Ekspertëve,
Maksud Ali, d.v.